



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:198573

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05736316

CAP.nr.452/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren, Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina”, sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Y... B... nga P..., për shkak të përmbarimit të kërkesës në të holla-borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.920/2021, të datës 07.09.2022, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e debitorit Y... B... nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.920/2021, të datës 07.09.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.920/2021, të datës 07.09.2022, e ka hedhë poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit Y... B... nga Prishtina, rruga “Ilir Durmishi”, LL-12, i paraqitur ndaj urdhrit të përmbaruesit privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë me shenjën P.nr.75/2021 i datës 20.01.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala debitore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës civile, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën e debitorit, të prish aktvendimin e marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe çështjen ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose ta ndryshoj aktvendimin e kundërshtuar.

Përgjigje në ankesën e debitorit nuk ka paraqitur pala kreditore.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK),

e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e debitorit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina", sh.a përmes përfaqësuesit të saj, ka paraqitur propozim për përmbare kundër debitorit Y... B...nga P..., në bazë të ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifër 30813, me të cilën figuron se debitori i detyrohet kreditorit në borxh në shumën prej 3,334.30 Euro.

Përmbareuesi privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë duke vepruar në bazë të propozimit për përmbare të kreditorit, me Urdhrin P.nr.75/21 të datës: 20.01.2021, ka lejuar përmbaremin. Kundër urdhrin për përmbare pala debitore ka paraqitur prapësim me datë 22.06.2021, ndërsa kreditori me dt. 25.06.2021 ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin të debitorit Y... B..., me datë 07.09.2022 ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.920/2021, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit Y... B... , duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhrin përmbare debitori e ka pranuar me datën 11.06.2021, ndërsa prapësimi nga debitori është dorëzuar me datë 22.06.2021 e cila konfirmohet nga plikojat që gjendet në shkresat e lëndës, pra 3 (tri) ditë, pas kalimit të afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditësh për paraqitjen e prapësimin, andaj nga këto arsye ka vendosur që prapësimin e debitorit Y... B..., ta hedhë poshtë si të pasafatshëm.

Konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të goditur si të rregullt dhe të bazuar në ligj e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkak se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat gjykata ankimore kujdeset çdoherë sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me mënyrën e vendosjes të cilat kanë mbështetje në provat shkresore dhe në ligj.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, lidhur më ankesën e parashtruar ka gjetur se me të drejtë është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë se prapësimi i parashtruar nga debitori është paraqitur pas afatit të përcaktuar ligjor, për shkak se, sipas fletëkthesës për dorëzim personal është konstatuar se debitori Urdhrin për lejimin e përmbaremin e ka pranuar me datë 11.06.2021, ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 22.06.2021, pra, pas afatit ligjor prej 7 ditësh. Gjykata e Apelit duke u kujdesur për prezumimet procedurale lidhur me lejueshmërinë e prapësimin, për të cilat prezumime gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në çdo fazë të procedurës, gjeti se prapësimi i parashtruar ndaj urdhrin përmbaremin nga arsyet e cekura është parashtruar pas afatit ligjor, andaj duke u bazuar në nenin 73 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilin është paraparë se "*Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*", si dhe

në nenin 70 të po këtij ligji, në të cilin është paraparë se ” *Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues*”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe, sepse debitori nuk ka mundur t’i provoj pretendimet e tija ankimore për afatshmërinë e prapësimit.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.452/2023, datë 27.05.2024

Gjyqtarja

Halide Reka